REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHËRBIMEVE PUBLIKE,ZHVILLIMIT URBAN DHE RURAL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Nr. 5555/1 **Prot** **Lushnje,më** 14.07 **2025**

PROJEKT- VENDIM

NR 67 **DATË** 14/07/**2025**

"PER NDRYSHIMIN DHE SHTESËN NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR 119 DATE 11.12.2007 " PER MIRATIMIN E KRITEREVE TE PERZGJEDHJES TE DREJTUESEVE DHE MJETEVE PËR DHENIEN E LICENCAVE PER AUTOMJETET 4+1 DHE 8+ 1 "

Në zbatim të Ligjin nr 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore " i ndryshuar, Ligji nr 8308 datë 18..03.1998 " Për transportet rrugore" i ndryshuar ,Ligjit nr 8378 datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar , Vendimit të Këshillit të Ministrave nr 633, date 26.10.2018 " Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje pozitive dhe ata me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshem për përdorim në automjete"i ndryshuar ,Udhëzimit nr.5627 datë 18.11.2016 "Për përcaktimin e kritereve , rregullave dhe dokumentacionin për leshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit " i ndryshuar ,Udhëzimit 12 datë 12 datë 19.07.2007 për " Përcaktimin e numrit të autoveturave taksi, shtypjen dhe emertimin e licencave , blloku të udhëtimit dhe regjistrit të sherbimit taksi " i ndryshuar ,si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike ,

Adresa : Lagja Kongresi Lushnjes Tel:+355 35 22139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

PROPOZOJMË:

1-Të miratojë ndryshimin të VKB-së Nr 119 dt.11.12.2007 "Për miratimin e kritereve të perzgjedhjes te drejtuesve dhe mjeteve per dhenien e licencave per automjetet 4+1 dhe 8+1" si më poshtë vijon:

- Viti i prodhimit të të gjithë llojeve të automjeteve të shërbimit taksi për ato subjekte/individë të cilat do të aplikojnë për tu licensuar në këtë shërbim për herë të parë do të jetë sipas parashikimeve të VKM -Së nr. 663 datë 26.10.2018 " Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorrike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndjezje pozitive nga ana me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim automjete" i ndryshuar.

2- Të miratojë shtesën si më poshtë :

- Ngjyra e mjeteve për këtë shërbim të jetë e verdhë për makinat , që kërkojnë të licesohen për here të pare taksi, përjashtim nga parashikimi i përcaktuar bëjnë automjetet elektrike të shërbimit taksi 4+1 të cilat janë me ngjyrë të pakushtëzuar.

3.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

DREJTOR I DR.JURIDIK
BEDRI HIDA

I AUTORIZUARI
DREJTORISË SËSHËRBIMEVE
ELTON KOROVESHI

KRYETAR I BASHKISË
ERISELDA SEFA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Adresa : Lagja Kongresi Lushnjes Tel:+355 35 22139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

Konfirmohet
Eriselda Sefo

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHËRBIMEVE PUBLIKE,ZHVILLIMIT URBAN DHE RURAL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Nr. 5955 **Prot** **Lushnje,më** 14.07 **2025**

RELACION

KËSHILLIT BASHKIAK

Këtu

"PER NDRYSHIMIN DHE SHTESËN NE VENDIMIN E KESHILLIT BASHKIAK NR 119 DATE 11.12.2007 " PER MIRATIMIN E KRITEREVE TE PERZGJEDHJES TE DREJTUESEVE DHE MJETEVE PER DHENIEN E LICENCAVE PER AUTOMJETET 4+1 DHE 8+ 1 "

Bazuar në ligjin nr 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore " i ndryshuar, Ligji nr 8308 datë 18..03.1998 " Për transportet rrugore" i ndryshuar ,Ligjit nr 8378 datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar , Vendimit të Këshillit të Ministrave nr 633, date 26.10.2018 " Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje pozitive dhe ata me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshem për përdorim në automjete"i ndryshuar ,Udhëzimit nr.5627 datë 18.11.2016 "Për përcaktimin e kritereve , rregullave dhe dokumentacionin për leshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit " i ndryshuar ,Udhëzimit 12 datë 12 datë 19.07.2007 për " Përcaktimin e numrit të autoveturave taksi, shtypjen dhe emertimin e licencave , blloku të udhëtimit dhe regjistrit të sherbimit taksi " i ndryshuar,

Të nderuar këshilltarë,

Ky relacion hartohet me qëllim informimin dhe argumentimin për domosdoshmërinë e përditësimit të kritereve të licensimit të automjeteve që kryejnë shërbimin taksi në territorin e Bashkisë Lushnje .Qëllimi kryesor është përshtatja e politikave vendore me standartet

bashkëhore për transportin urban , mbrojtjen e mjedisit ,reduktimin e ndotjes së ajrit , promovimin e teknologjive te gjelbërta , si dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit që i ofrohet qytetarëve.

Duke marrë në konsideratë zhvillimet teknologjike dhe kerkesat për mbrojtjen e mjedisit Bashkia Lushnje ka vleresuar të nevojshme të vendosë disa kritere shtesë për licensimin e mjeteve që do të ofrojnë shërbimin taksi , konkretisht:

Për vitin e prodhimit të automjeteve:

Eshtë e domosdoshme që mjetet të përmbushin normat mjedisore , duke aplikuar kushtet e përcaktuara nga VKM 663/2018 , për të reduktuar ndotjen e ajrit dhe emetimet ndotese nga motoret me djegje te brendshme. Kjo do të sjellë uljen e ndjeshme të emetimeve ndotëse të gazrave të dëmshëm për ajrin dhe shëndetin publik, uljen e zhurmave që vijnë nga mjetet motorike, si dhe përmirësimin e performancës teknike dhe sigurimit te një shërbimi me të sigurt për qytetarët.

Për ngjyrën e automjeteve:

Për të unifikuar dhe lehtësuar indetifikimin nga qytetarët , propozohet që ngjyra standarte për taksitë ne qytetin e Lushnjes të vazhdojë të jetë e verdhë , si një praktikë e njohur ndërkombëtarisht që i bën mjetet taksi lehtësisht të dallueshme në trafikun urban me përjashtim të taksive elektrike që propozojmë të jetë me ngjyrë të pakushtëzuar.

Pranë Bashkisë Lushnje ,subjektet që kërkojnë të licensohen në shërbimin taksi me automjetet elektrike , pretendojnë se kosto për të ndryshuar ngjyrën e mjetit janë shumë të larta ,ndërkohë që në qytet i duhet dhënë prioritet përdorimit sa më të gjerë të taksive elektrike për vetë efektin negative shumë të ulët që kanë në ndotjen e ajrit , ndotjen akustike.

Ndodhur në këto kushte ,Bashkia Lushnje vlerson që kriteri i ngjyrës për taksitë elektrike nuk është i nevojshëm pasi sjell kosto shumë të larta për operatorët e shërbimit taksi duke sjellë për pasojë uljen e shërbimit taksi me automjete elektrike të cilat konsiderohen " miqësore për mjedisin" . Elementet e identifikimit për shërbimin taksi (Logo, nr i licencës, targa T) mbeten të detyrueshëm dhe të mjaftueshëm për ta dalluar qartë mjetin që operon si taksi , dhe pa kushtëzimin e nje ngjyre specifike.

Ngjyra specifike detyron operatorët të investojnë shtesë për modifikimin e pamjes së mjetit , duke rritur kostot fillestare .Kjo mund të pengojë adoptimin e teknologjive të reja ekologjike si taksitë elektrike . Eshtë një mënyrë për të inkurajuar operatorët të investojnë në teknologji më të pastra dhe për të krijuar një flotë modern taksish që reflekton kujdesin për mjedisin.Gjithashtu në shumë qytete të tjera , taksitë elektrike gëzojnë lehtësira të vecanta për të nxitur përhapjen e tyre.

Adresa : Lagja Kongresi Lushnjes Tel:+355 35 22139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

Zbatimi i këtyre propozimeve sjell disa përfitime të prekshme për komunitetin duke përmirësuar cilësinë e jetesës në qytet përmes reduktimit të ndotjes së ajrit , krijon një standart të unifikuar dhe transparent për të gjithë operatorët që ofrojnë shërbimin taksi .

Duke marrë në konsideratë të gjitha argumentat e sipërmenduara , Ju paraqesim për miratim këto ndryshime , si një masë konkrete për modernizimin e transportit publik ,përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe mbrojtjen e shëndetit publik.

Duke Ju falenderuar,

Konc: Snl për Transportin&Licensat profesionale
Xh. Tosku

I AUTORIZUARI
DREJTORISË SË SHËRBIMEVE PUBLIKE
ELTON KOROVESHI

Adresa : Lagja Kongresi Lushnjes Tel:+355 35 22139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com